



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 23 tetor 2020, në mbledhjen e pestë (5) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10.05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z.Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë; z.Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Ndërsa munguan: z.Besfort Kruma, toger, përfaqësues i FSK-së; z.Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; znj.Albina Avdiu, kryesuese e Komitetit për Komunitete; znj.Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; z.Zaim Thaçi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe z.Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës theksoi, përshëndetje për të gjithëve, siç shihet jemi duke i respektuar masat në funksion të parandalimit të pandemisë Covid-19, atëherë mirë se keni ardh në mbledhjen e pestë të KKS-së.

Materialet për mbledhje konsideroj i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22 shtator 2020

U miratua njëzëri

2.Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës theksoi, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bekim Zogiani.

z. Bekim Zogiani, theksoi, sa i përket situatës së sigurisë në Komunën e Podujevës gjendja është e qetë dhe stabile, nuk kemi ndonjë informacion për ndonjë protestë apo ndonjë organizim tjetër që do ta prishte rendin dhe qetësinë publike në përmasa të mëdha. Sa i përket numrit të rasteve në periudhën raportuese për shkak se tani e kemi përfunduar 9 mujorin që në bazë të një analize që kemi bërë prej datës 01.01.2020 deri më sot i kemi të evidentuar 880 raste të ndryshme kriminale që në krahasim me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2019 kemi një ngritje të rasteve për shkak të numrit të rasteve të cilat janë paraparë me kodin penal me shfaqjen e pandemisë, do të thotë se kemi 60 raste të evidentuar gjatë këtij 9 mujori që krahasuar me periudhën e njëjtë 2019 rezulton me ngritje të rasteve për 14%. Sa i përket aktiviteteve tjera të policisë janë intensifikuar në maksimum që nga hyrja në fuqi Ligjit nr.07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Nga policia janë shqiptuar gjithsej 1168 gjoba për mos bartje të maskave dhe mos mbajtjen e distancës nga qytetarët. Është shumë shqetësuese kjo dukuri sepse kohën e fundit nga qytetarët ka rënë vullneti për bartje të maskave andaj ju bëjë thirrje që të ndikoni secili në mënyrën e tij për vetëdijesimin e qytetarëve për bartjen e maskave dhe respektimin e masave tjera anti Covid-19. Vetëm gjatë ditës së djeshme për mos bartjen e maskave dhe mbajtjen e distancës nga policia janë shqiptuar 105 gjoba, gjendje e cila nënkupton se në terren kërkon angazhimin e gjitha institucioneve publike; policisë, inspektionit dhe gjithë qytetarëve që kanë ndikim për vetëdijesimin e qytetarëve për bartjen e maskave dhe masave tjera anti Covid-19.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, falënderojmë Komandantin për informacionet rreth gjendjes së sigurisë në Komunën e Podujevës. Pasi që përfaqësuesi i FSK-së nuk është prezentë, fjalën e ka përfaqësuesi i KFOR-it.

Përfaqësuesi i KFOR-it, togeri Kovatcs, theksoi, sa i përket gjendjes së sigurisë në Komunën e Podujevës nga ana e KFOR-it, vlerësohet e qetë dhe stabile. Situatën rreth pandemisë Covid-19, jemi duke përcjellë dhe sipas vlerësimit të sektorit të shëndetësisë nga ana e KFOR-it, tani pritet të fillojë vala e dytë e pandemisë Covid-19. Kemi udhëzimet e zyrës së Komandantit të KFOR-it që të kemi parasysh gjendjen rreth pandemisë Covid-19, të kemi një bashkëpunim sa më të afërm me organet Komunale e që në baza javore të kemi takime sa më të shpeshta rreth koordinimit për gjendjen e pandemisë Covid-19. Sa i përket misionit apo mandatit të KFOR-it nuk ka ndonjë ndryshim, mandati mbetet i njëjtë sa i përket gjendjes së sigurisë dhe lëvizjes së lirë. KFOR-i është institucioni i tretë që përgjigjet për gjendjen e sigurisë dhe gjendjes së pandemisë Covid-19.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, i falënderoj dy raportuesit për raportet e dhëna por më shumë për punën që po e bëjnë që gjendja e sigurisë në Komunë të mbetet e qetë dhe stabile duke i'u falënderuar institucioneve përgjegjëse por edhe qytetarëve të Komunës së Podujevës. Ndihe mi mirë kur në territorin e Komunës së Podujevës nuk kemi raste të theksuara që do të ndikojnë në sigurinë e përgjithshme të Komunës apo në sigurinë e përgjithshme nacionale. Nëse nuk keni diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

3.Informatë lidhur me gjendjen e Pandemisë - Covid 19 në Komunën e Podujevës

- Shëndetësia

- Arsimi

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, para dy ditëve mbajtëm mbledhjen e shtabit emergjent për shkak të rritjes së numrit të rasteve të reja me Covid-19, ku kemi diskutuar për situatën epidemiologjike në Komunën e Podujevës dhe për masat e shtuara për zbatimin e vendimeve dhe udhëzimeve të ndryshme të institucione përgjegjëse Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKSHPK-së. Në dy javët e fundit kemi një shtim të numrit të rasteve pozitive me Covid-19, ku ne si shtab emergjent duhet të jemi më të përgatitur që të ballafaqohemi me situatën. Të gjitha informacionet që kemi dhe në bazë të njoftimeve në media edhe Kosova nuk do të jetë e paprekur nga vala e dytë e virusit Covid-19, sepse kushtet klimatike janë të favorshme për përhapjen e virusit për shkak se uljes së temperaturave, por ekziston rreziku edhe të bashkimi i viruse të ndryshme siç është gripi sezonal dhe ai Covid-19. Për të përballuar dhe të menaxhojmë sa më mirë një situatë të tillë është mirë që Shtabi Emergjent, QKMF-ja, Policia dhe Inspekcioni të jenë në krye të detyrës. Është për keqardhje shqiptimi i gjobave nga Policia për mos bartje të maskave dhe mos mbajtjen e distancës nga qytetarët, mirëpo në të njëjtën kohë është edhe për lëvdatë për punën që bën policia. Të gjithë duhet të punojmë në vetëdijesimin e qytetarëve në parandalimin dhe luftimin e virusit Covid-19 dhe të ulet numri i gjobave të shqiptuara, të japim shembull dhe të përçojmë mesazh për respektim të ligjit dhe zbatim të udhëzimeve dhe rekomandimeve të institucioneve relevante në parandalimin dhe luftimin e virusit Covid-19. Gjendja me pandeminë Covid-19 është alarmante edhe pse numrin e rasteve pozitive nuk e kemi aq të madh sepse nuk kemi arritur që të marrim numër të madh të mostrave, ka shumë njerëz që këtë virus e kalojnë pa shenja apo simptoma, mirëpo sipas ekspertëve edhe këta persona asimptomatik mund ta përhapin virusin te personat tjerë. Sa i përket numrit të të prekurve nëpër media ju do të shihni shifra dhe statistika që e nxjerrin numrin më të madh të infektuarave por ne e kemi fjalën vetëm për banorët rezident të Komunës së Podujevës sepse ka shumë qytetarë të Komunës së Podujevës që jetojnë me vite të tëra në qytetet tjera si në Prishtinë dhe Fushë Kosovë por në dokumentet e tyre të identifikimit ende janë banorë të Komunës së Podujevës andaj në momentin e regjistrimit në statistikat e IKSHPK-së ata regjistrohen si banorë të Komunës së Podujevës dhe në statistika del numri më i lartë i personave të infektuar me Covid-19. Në Komunën e Podujevës janë 669 raste pozitive, prej tyre 593 të shëruar, 54 janë aktiv por jashtë rrezikut për jetën dhe fatkeqësisht 22 që kanë përfunduar me fatalitet. Kemi një rritje të rasteve me Covid -19, që nëse e marrim si shifër në përgjithësi nuk është shqetësuese, mirëpo është shqetësuese nëse e krahasojmë me numrin e rasteve para dy jave që kemi pas 20 persona aktiv, e që për momentin kemi dyfishim të rasteve pozitive me Covid-19 dhe fatkeqësisht ky numër është duke u rritur. Duhet të jemi të përgatitur që situata të mos eskaloj, sepse ekonomia e Kosovës nuk do ta përballonte edhe një mbyllje dhe qytetarët nuk do të ishin në gjendje të përballonin masat e karantinimit.

Fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale z. Zaim Thaçi , e pastaj Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Agim Blakçori.

z. Zaim Thaçi drejtor i DSHMS, theksoi, duke i'u falënderuar bashkëpunimit të Komunës së Podujevës me Ministrinë e Shëndetësisë jemi komuna e vetme që ofrojmë shërbime të nivelit parësor shëndetësor për marrjen e mostrave për qytetarët e dyshuar me virusin Covid-19, ku deri më tani i kemi marrë 2700 mostra në QKMF-Podujevë. Shifrat deri në fund të muajit shtator ishin shumë inkurajuese kurse në javën e parë të muajit tetor është rritur numri i rasteve pozitive me Covid-19. Një ditë më parë nga 11 mostra të marra kanë rezultuar 7 pacient pozitiv me Covid-19, që nënkupton se kalon mbi 50% numri i të infektuarve. Marrja e mostrave është intensifikuar kohëve të fundit

por një gjë është inkurajuese sepse nga 60 raste aktive me Covid-19 që i kemi vetëm një pacient është i shtrirë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, kurse gjendja e 59 pacientëve tjerë është stabile dhe ata janë duke u trajtuar në shtëpitë e tyre, ku ekipet mjekësore iu ofrojnë ndihmë në shtëpitë e tyre dhe në institucionet shëndetësore. Ditëve të fundit po sfidohemi nga ulja e temperaturave dhe nga rritja e frekuencës së transportit publik dhe nga aktivitetet nëpër shkolla. Mendoj se me lirim të masave jemi duke u sfiduar dhe mund të them se e kemi pritur këtë rezultat, mirëpo na mbetet më shumë përkushtim i përbashkët i të gjitha institucioneve relevante në nivel të Komunës. Vazhdimisht çdo ditë i marrim rezultatet nga IKSHPK-ja, ku rezultatet i marrim prapë me vija të kuqe që nënkupton se gjendja është alert dhe jemi në një situatë të një alerti dhe me theks të veçantë kemi një rekomandim që të kontrollohen të gjitha hyrje daljet për lagjet dhe shtëpitë ku ka raste pozitive me Covid-19, ose raste të kontakteve për të parandaluar përhapjen e infeksionit. Na mbetet një sfidë si institucion shëndetësor që të punojmë dhe të bashkëpunojmë me organet e rendit, në veçanti me inspektorët komunal në përcjellje të lëvizjes së personave pozitiv me Covid-19.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës theksoi, sa i përket ballafaqimit me virusin Covid-19 në shkolla, si Komunë jemi në mbikëqyrje të tyre përmes zyrtarëve të DKA-së por edhe përmes Policisë (zyrtarëve policor që i mbikëqyrin shkollat). Është një situatë e menaxhuar në nivel të shkollave. Nga vizitat që i kam bërë në shkolla me Ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, është vlerësim i imi se janë duke u zbatuar më mirë udhëzimet, rekomandimet dhe masat anti Covid-19. Është kënaqësi e madhe me hy në shkolla pa paralajmërim dhe t'i shohësh të gjithë nxënësit e pajisur me maska dhe dezinfektues në tavolina. Fillimisht kemi pas probleme me prindërit e nxënësve, kryesisht me ciklin e ultë para fillor dhe fillor për grumbullim të madh në hyrjet e objekteve shkollore. Deri më tani sipas informacioneve kanë rezultuar pozitiv me Covid-19 gjashtë nxënës dhe gjashtë mësimdhënës por fatmirësisht nxënësit dhe mësimdhënësit një javë para se të rezultojnë pozitiv me Covid-19, kanë qenë të vetë izoluar dhe nuk kanë pas kontakte me persona tjerë, por mundësia e përhapjes së virusit është e madhe sepse ka grumbullim të madh të njerëzve në shkolla. Kemi apeluar te mësimdhënësit dhe prindërit nëse vërejnë ndonjë ndryshim në gjendjen e tyre shëndetësore qoftë ndonjë temperaturë e lehtë apo ndonjë ndryshim tjetër është mirë që ata fëmijë mos të vijojnë mësimet deri sa t'iu kaloj ajo gjendje.

z. Agim Blakçori, theksoi, fillimi i vitit të ri shkollor 2020/21 në kushte pandemie në Komunën e Podujevës është duke u zhvilluar sipas tre skenarëve apo modaliteteve të rekomanduara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Sipas skenarit A të gjithë nxënësit vijojnë mësimet në shkollë me orar dhe përmbajtje të reduktuar por që mësimin e vijojnë direkt në shkolla dhe organizohet po thuajse në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën e Podujevës me përjashtim të shkollave “Naim Frashëri” dhe “Ibrahim Rugova”, kurse në shkollat tjera vazhdon mësimi me prezencë të nxënësve dhe mësimdhënësve duke i respektuar rekomandimet nga institucionet përkatëse. Sipas skenarit B mësimi zhvillohet në tri shkollat e mesme në Komunën e Podujevës ku është bërë një plan dhe zhvillohet me rotacion një javë një grup punon në shkollë kurse javën tjetër ai grup punon nga shtëpia përmes aplikacioneve, modaliteteve dhe platformave të ndryshme elektronike, kurse javën tjetër kthehet grupi tjetër dhe kështu me rotacion jemi duke e zhvilluar procesin mësimor tash e një muaj dhe deri më tani e kemi situatën nën kontroll. Skenari C rekomandon që mësimi të mbahet vetëm nga distanca, zhvillohet vetëm në raste kur paraqitet ndonjë rast pozitiv me Covid -19, në klasa apo në shkolla, ku pas analizës dhe vlerësimit që bëhet nga Task-forca në nivel të shkollës dhe konsultimit

me ekspertët shëndetësorë atëherë vendoset se si do të veprojmë, nëse vlerësohet se gjendja e krijuar paraqet rrezik atëherë klasa mund të kalojë në mësim nga distanca për aq kohë sa vlerësohet rreziku nga përhapja e virusit. Kemi disa raste ku pas paraqitjes së rrezikut klasa ka kaluar në mësim në distancë, ku rastin e fundit e kemi një ditë më parë, me rezultimin pozitiv të dy mësimitdhënësve dy shkolla kanë kaluar në mësim online nga distanca deri në testimin e radhës të atyre mësimitdhënësve. Drejtoria e Arsimit në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor, duke pas parasysh rrethanat në të cilat jemi ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, sikurse e konfirmoi edhe kryetari në fjalën e tij hyrëse. Jemi duke vazhduar me dezinfektimin e objekteve shkollore çdo javë, gjithashtu kemi bërë furnizimin me të gjitha mjetet e nevojshme higjienike për ta përballuar më lehtë pandeminë Covid-19, siç janë doreza, dezinfektues, termometër etj, në të gjitha objektet shkollore. Momentalisht në shkollat e Komunës së Podujevës kemi katër mësimitdhënës që kanë rezultuar pozitiv me Covid-19, nga ta dy mësimitdhënës janë në shkollën ‘Ibrahim Rugova’, një në shkollën ‘Xheladin Rekaliu’ dhe një në shkollën ‘Pavarësia’. Këto dy rastet e fundit janë të ditës së djeshme dhe për këtë arsye kam vendosur Taskë-Forcën në nivel të shkollave që mësimitdhënësit të shkojnë në testim dhe mësimi të zhvillohet nga distanca. Rastet në shkollën ‘Ibrahim Rugova’, janë më të hershmen, ne kemi vazhduar mësimin në distancë për dy javë dhe asnjë nxënës nuk ka paraqitur ndonjë simptomë të virusit Covid-19. Kemi bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante në mënyrë që sa më lehtë ta përballojmë gjendjen e pandemisë dhe momentalisht gjendja është nën kontroll dhe urojmë që kjo gjendje mos të përkeqësohet.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, falënderojmë drejtorin për informatën e paraqitur, nëse nuk diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

4. Informatë për sigurinë në shkolla

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, sigurisht nuk mund ta shkëpusim komplet këtë pikë të rendit të ditës prej pikës paraprake sepse edhe Covid-19 ndikon në sigurinë e shkollave. Siguria në shkolla ngërthen shumë më tepër jo vetëm në sigurinë fizike por edhe në sigurinë shëndetësore, psikologjike, andaj është mirë që së bashku me Policinë e Kosovës po vazhdojmë mbikëqyrjen e shkollave ku edhe me anë të kamerave të sigurisë vazhdojmë monitorimin e tyre dhe për këtë nxënësit janë të vetëdijshëm se shkollat mbikëqyren nga kamerat. Çështje që ndërlidhet me sigurinë e nxënësve në shkolla ka qenë edhe heqja e një plepi i cili ka qenë në oborrin e shkollës ‘Shaban Shala’ i cili që ka paraqitur rrezik për sigurinë e nxënësve dhe kalimtarëve. Për heqjen e tij kemi pas kërkesa të më hershme mirëpo në mungesë të operatorëve ekonomik që nuk kanë pas pajisje adekuate nuk kemi mundur ta heqim, mirëpo tanimë kemi heq atë plep dhe dy plepa tjerë në afërsi të Qendrës për Kulturë të Teatri i qytetit sepse edhe ata kanë paraqitur rrezik për sigurinë e qytetarëve.

z. Agim Blakçori, theksoi, shikuar në përgjithësi por edhe duke u bazuar në raportet e policisë, drejtorëve të shkollave dhe të DKA-së, mund të vlerësojmë se edhe këtë vit gjendja e sigurisë në shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë, stabile dhe e sigurt. Këtë e përforcon edhe më shumë mbarëvajtja e procesit mësimor. Siguria e shkollave dhe masat për parandalimin e dhunës kanë rëndësi mirëpo tani si temë kyçe kemi luftimin dhe parandalimin e pandemisë Covid-19. Gjithashtu rëndësi të madhe i kushtojmë edhe fuqizimit të organeve udhëheqëse profesionale të shkollave. Task Forcat e ngritura janë duke luajtur një rol të rëndësishëm në përcjelljen e gjendjes së pandemisë, kur dihet se në kuadër të tyre kemi nxënës, mësimitdhënës, prindër dhe drejtorë të shkollave në mënyrë që t’i kemi informatat sa më burimore, sa më herët, në mënyrë që ti planifikojmë sa më mirë

aktivitetet dhe vendimet tona. Rëndësi i kemi kushtuar shërbimit pedagogjik dhe psikologjik nëpër shkolla. Këtë vit kemi zhvilluar procedurat për punësimin edhe 4 psikologëve. Në komunën e Podujevës sigurohet transporti për të gjithë nxënësit të cilët udhetojnë më shumë se 4 km në një drejtim deri në shkollë, kemi disa fshatra të thella që ju ofrojmë këtë shërbim, gjithashtu edhe nxënësve me nevoja të veçanta të cilët mësimin e zhvillojnë në paralele të ndara në shkollën “Kongresi i Manastirit”, në fshatin Gllamnik. Renovimit dhe hapësirave shkollore gjithashtu u kemi kushtuar rëndësi, këtë vit kemi planifikuar 19 objekte shkollore për rinovim, disa prej tyre janë përfunduar dhe në disa janë duke u zhvilluar punimet. Rrethojat e shkollave këtë vit i kemi planifikuar në shkollat të cilat nuk kanë rrethoja apo u janë dëmtuar. Sa i përket trotuareve Drejtoria e Shërbime Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit çdo herë prioritet ka trotuaret në afërsi të shkollave si në zonat urbane ashtu edhe rurale, meqë ndërtimi i trotuareve ka ndikuar pozitivisht në sigurinë e nxënësve. Besoj se të gjitha ato rrugë dhe trotuare që kanë mbetur pa u rregulluar pranë shkollave do të jenë në prioritet nga Drejtoria përkatëse. Bashkëpunimi me policinë vazhdon të jetë në nivelin e duhur, kemi kontakte të rregullta dhe çdo herë që e shohim të nevojshme organizojmë edhe takime të drejtpërdrejta. Çdo herë e kemi pas mbështetjen e tyre, me ç’rast e falënderoj komandantin e policisë dhe policinë në përgjithësi për bashkëpunimin dhe ofrimin e ndihmës. Në të kaluarën kemi pas bashkëpunim edhe në ofrimin e ligjëratave me karakter senzibilizues kundër dukurive negative, mirëpo urojmë që gjendja me pandeminë të përmirësohet dhe këto planifikime që i kemi ti realizojmë në të ardhmen. Instalimi i kamerave në shkolla ka pas efekt pozitiv sidomos në qytet në ato shkolla ku kemi bërë instalimin e tyre. Këtë vit është planifikuar që në 16 shkolla të bëhet instalimi i kamerave. Përkundër vlerësimeve pozitive kemi edhe sfida dhe vështirësi me të cilat ballafaqohemi çdo ditë me sigurinë e nxënësve. Sfida më e madhe për momentin është pandemia Covid-19, përkundër faktit se gjendja është stabile por mund të presim që gjendja në terren mund të përkeqësohet, ndërsa incidentet dhe zënkat mes të nxënësve vazhdojnë, sidomos në shkollat e mesme ku kemi raste më të theksuara si dhe raste të dëmtimit të objekteve shkollore nga persona të panjohur, pas përfundimit të orarit mësimor, ku në këto raste policia ka vepruar dhe nga ana e gjykatës këta persona janë dënuar. Lokalet afër shkollave paraqesin rrezik për sigurinë e nxënësve, sidomos te shkollat e mesme dhe te shkollat tjera në qytet, këtë e kemi potencuar disa herë, sepse veprimtaria e tyre ndonjëherë mund të jetë e dyshimtë dhe është mirë që policia e Kosovës në bashkëpunim me inspektionin të bëjnë plane konkrete dhe të veprojnë kohë pas kohe. E drejtë e secilit është që të bëjë biznes por detyrë e jona si institucione është të marrim masa dhe t’i parandalojmë dukurit negative antiligjore në këto biznese. Qenët endacak vazhdojnë të mbesin një problem edhe për komunën tonë si në gjithë komunat tjera të Republikës së Kosovës por gjithashtu edhe komunikacioni rrugor paraqet njërin prej rreziqeve për sigurinë e nxënësve në vajtjen dhe ardhjen e tyre në shkollë sepse shpeshherë trotuaret po shfrytëzohen për parkim të makinave nga persona të pa përgjegjshëm. Mungesa e rojeve në disa shkolla paraqet rrezik për sigurinë e objekteve shkollore ku në mungesë të tyre po thyhen disa objekte shkollore nga persona të papërgjegjshëm. Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor do të ndërmerë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar një mjedis të qetë dhe të sigurt në të gjitha institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës theksoi, u përmenden disa punë nga drejtoria që janë kryer dhe po kryhen, e që ndikojnë drejtpërdrejtë në sigurinë e përgjithshme në shkolla, si ndërtimi i trotuareve, ndriçimi etj, janë për tu përshëndetur, sepse numri më i

madh i shkollave i kanë të rregulluara trotualet afër tyre pastaj jemi duke vazhduar me ndriçimin publik në të gjitha rrugët që përshkojnë afër shkollave. Rrethojat sigurisht edhe për një periudhë të gjatë kohore janë të domosdoshme dhe kanë rëndësi të veçantë në sigurinë e nxënësve, në veçanti në shkollat e qytetit. DKA duhet të shikojë mundësinë buxhetore që të gjitha atyre shkollave që i kanë rrethojat e dëmtuara qofshin shkolla fillore apo të mesme t’iu ndërtohen rrethoja të reja. Sa i përket rojave të objekteve shkollore duhet shikuar mundësitë buxhetore dhe atë të numrave të liruara të punësuarave në arsim për sigurimin e rojave sepse kemi projekte të rëndësishme për arsim si pajisja e shkollave me teknologji informative dhe kompjuter, me kabinete dhe laboratorë dhe në shkollat ku nuk kemi roje investimi ynë është i rrezikuar sepse kemi parashikuar një shumë bukur të madhe të mjeteve që këtë vit ti pajisim shumicën e shkollave me kabinete të informatikës, me kompjuterë të ri dhe me laboratorë të fizikës, biologjisë dhe kimisë, kështu që duhet me shikuar mundësinë e rritjes së numrit të punëtorëve për roje të objekteve shkollore. Një lajm i mirë është që Fondi Kosovar për Eficiencë të Energjisë Elektrike ka vendosur që edhe dy shkolla të Komunës së Podujevës, “Luigj Gurakuqi” dhe “Enver Maloku” në Podujevë t’i fus në kuadër të projektit me termo izolim për shkak të eficiencës elektrike. Lidhur me problemin e qeneve endacak kemi pas një takim online me Ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorin Ekzekutiv të AVUK-ut, Shefin e Operacioneve të Policisë së Kosovës nga Drejtoria e Përgjithshme dhe me Kryetarët e Komunave ku është trajtuar çështja e qeneve endacak dhe sinqerisht kemi debatuar më shumë se dy ore ku të gjithë kryetarët e komunave janë jashtëzakonisht të shqetësuar me gjendjen që Kosova si shtet nuk po mund t’i bëjë zgjidhje këtij problemi e posaçërisht tani në periudhën e dimrit. Deri më tani edhe ato fonde që janë nda nga shteti për trajtimin e qeneve endacak pothuajse kanë shkuar kot sepse nuk është arrit ndonjë rezultat ku fatkeqësisht dje në Prishtinë është sulmuar një grua shtatzëne nga qenët endacak, me të vërtetë është kjo gjendje është shqetësuese. Çështja e trajtimit të qeneve endacak ka mbetur pezull, në anën tjetër kemi organizata për mbrojtjen e kafshëve, por edhe ne jemi pro mbrojtjes së tyre mirëpo kur të cenohet siguria dhe jeta e qytetarëve ne duhet të marrim masa adekuate. Kemi përpjekjet e Qeverisë dhe të Avuk-ut, që këtë çështje ta zgjidhin me faza, siç është zënia e qeneve endacak dhe sterilizimi i tyre, pastaj lëshimi i tyre në natyrë- liri që është masa më e mirë, por fatkeqësisht në Kosovë ende nuk ka dhënë ndonjë rezultat të pritshëm. Janë shpenzuar rreth 1,200,000.00€, që ka qenë buxheti i AVUK-ut, ndërsa rezultatet me të vërtetë janë dekurajuese. Trajtimi i qeneve endacak është një çështje nacionale që nënkupton se nuk është një problem që kërkon zgjidhje nga niveli lokal. Çështja e qeneve endacak ka mbetur një problem i pa zgjidhur por kjo nuk do të thotë se ne si Komune të mos marrim masa andaj është mirë të mendojmë se çka mund të bëjmë. Ne si institucion duhet të apelojmë edhe te qytetarët që kafshët e tyre shtëpiake t’i vaksinojnë dhe mos t’i mbajnë nëse nuk kanë mundësi apo dëshirë, sepse më pas po i lirojnë në qytet ku paraqesin rrezik për jetën dhe sigurinë e qytetarëve. Duhet të apelojmë që nëse kanë nevojë të lirohen nga kafshët e tyre shtëpiake është mirë të konsultohen me veterinerët sepse është përmend mundësia e përdorimit të eutanazisë apo siç quhet ndryshe vdekjes së butë me injeksion. Deri më tani ne si shoqëri këtë dukuri e kemi identifikuar si problem por nuk kemi bërë sa duhet që kjo çështje të zgjidhet.

5. Informatë për sigurinë në komunikacion

z. Bekim Zogiani, theksoi, sa i përket sigurisë në komunikacion, në përgjithësi e kemi një situatë të njëjtë gjatë kësaj periudhe raportuese. Në vitin 2019 kemi evidentuar 1148 aksidente, ndërsa në periudhën e njëjtë 2020 i kemi evidentuar 1148, që do të thotë se kemi numër të njëjtë të aksidenteve. Për mos respektim të rregullave në komunikacion ka ngritje të numrit të gjobave të shqiptuara për kundërvajtësit, prej 5360 gjobave që janë shqiptuar në vitin 2019, këtë vit kemi shqiptuar 5432 gjoba. Ju njoftojmë se gjatë detyrave rutinore të policisë kemi një pengesë sa i përket tërheqjes së veturave për shkak se kompanisë së kontraktuar i ka skaduar afati kontratës. Veturat që parkohen në vende të ndryshme publike ku pengohet qasja e të tjerëve është e pamundur që të largohen përveç shqiptimit të një gjobe, andaj kërkoj që të kontraktohet një kompani për tërheqjen e veturave, kjo do na e lehtësonte punën, por do të lehtësonte edhe lëvizjen e qytetarëve në trotuare dhe hapësira të ndryshme publike. Në rrugën magjistrale Podujevë-Prishtinë përkundër faktit se janë duke u zhvilluar punime nuk ka ndonjë ngritje në bazë të evidencave të cilat i posedojmë ne.

z. Faik Muçiqi, theksoi, siguria në komunikacion është shumë dimensionale, por dy institucionet që merren më së shumti me to janë policia dhe inspektoratet komunale dhe qendrore. Ne dëgjuam dy tri pika nga Komandanti i policisë por siguria në komunikacion varet shumë nga infrastruktura në komunikacion, nga sjellja e qytetarëve, nga shërbimet që i kryejnë institucionet. Këtë vit DSHPMSh pavarësisht pavarësisht problemeve të shumta pas shfaqjes së pandemisë Covid-19, ka bërë vazhdimin e lejeve për të gjithë operatorët që bëjnë transportin e udhëtarëve, qoftë të atyre me auto taxi apo radio taxi, mini bus, apo autobus, pavarësisht nga ajo që i kemi liruar nga pagesa për bërjen e biznesit këtë vit, vazhdimin e lejeve. Njëkohësisht kemi pas ende kërkesa që transporti publik dhe privat ta shtojë cilësinë dhe kapacitetin ku kemi hapur konkursin për transport taxi dhe radio taxi të udhëtarëve, ku shpresojmë që hyrja e çdo operatori të ri në treg ndikon në sigurinë e komunikacionit sepse automjetet janë më të reja dhe rritet numri i të punësuarave, ka një konkurrencë, çmimi më i lirë dhe shërbime më të mira që ndikojnë në sigurinë e komunikacionit rrugor. Nga aspekti i infrastrukturës komuna ende vazhdon me asfaltime, që ende janë të shumta, brenda vitit së paku 50 km, gjithashtu vazhdohet në riparimin e asfalteve në qytet dhe në fshatra. Kemi kërkesa të shumta nga qytetarët për vendosjen e barrierave edhe aty ku rregullat e komunikacionit nuk i parashohin këto barrierë. Kemi shqyrtuar mbi 30 kërkesa dhe brenda qytetit i kemi vendosur disa pengesa më moderne të cilat po ndikojnë sa do pak në sigurinë e komunikacionit. Vazhdojnë punimet me ndriçimin publik që paraqet një siguri të veçantë në komunikacionin rrugor, ku këtë vit deri më tani kemi ndërtuar rreth 41 km. Në qytet do të vazhdojmë me përmirësimet e ndriçimit publik, ndërkohë punimet janë duke vazhduar në rrugën kryesore të fshatit Batllavë, ku pastaj do të zhvillohen punimet e ndriçimit me shtylla metalike, më moderne. Këtë vit kemi planifikuar ndërtimin e 15 km të trotuareve afër shkollave, 11 km trotuar janë përfunduar dhe shpresojmë se këtë vit do të arrijmë ta përfundojmë në tërësi projektin. Sipas kërkesa nga banorët, për vitin e ardhshëm do të vazhdohet me ndërtimin e trotuareve afër shkollave, ku kemi planifikuar afro 250,000€. Kemi filluar me shenjëzimet horizontale, shenjëzimet vertikale janë bukur shumë të vendosura me përjashtim të atyre që janë dëmtuar dhe fatkeqësisht ndonjëherë janë vjedhur. Si projekte që paraqesin problematikë në Komunën e Podujevës janë ndërtimi i sheshit dhe i rrugës magjistrale Podujevë-Prishtinë që në siguri dhe në mbarëvajtjen e komunikacionit janë duke ndikuar, në ngadalësimin e qarkullimit të qytetarëve, mirëpo qytetarët duhet ti shfrytëzojnë rrugët alternative Podujevë-Prishtinë, sepse përveç vonesave edhe rrezikshmëria në komunikacion është më e madhe tani kur

kanë filluar punimet në largimin e asfaltit. Ndërtimi i sheshit gjithashtu ka ndikuar në komunikacion, e di që policia ka probleme me parkingjet e posaçërisht me këto kompanitë e taxi-ve dhe radio-taxi. Shërbimit të merimangës sigurisht që i ka kaluar afati edhe pse në fillim të vitit kishim probleme me shfaqjen e pandemisë Covid-19, kompania ka shfaqur shumë ankesa sepse nuk ka pas ndonjë profit. Ndërkohë ne kemi përgatitë kërkesën për procedim për një operator të ri. Në qytet kemi edhe një problematikë tjetër me parkingjet pranë banesave ku në bashkëpunim dhe në konsultim me banorët kemi vendosur lura në hyrjet banesore që shërbejnë vetëm për automjetet e banuesve dhe të kompanive shërbyese, qoftë të pastrimit dhe kompanitë tjera që kryejnë shërbime. Dukuri tjera shqetësuese është vjedhja e kapakëve të pusetave po thuajse çdo javë dhe pas rivendosjes së tyre si dhe dëmtimet e ndriçimit publik dhe shenjëzimit dukuri negative ndikojnë direkt në sigurinë e komunikacionit. Këto janë disa pika që janë ndikuese në sigurinë e komunikacionit rrugor por shpresojmë që me përfundimin e infrastrukturës dhe modernizimin e saj dhe me zgjerimin e rrugëve në qytet dhe fshatra, me ndërtimin e ndriçimit publik dhe trotuareve do të kemi një siguri më të madhe në komunikacion.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, ju kërkoj ndjesë se për shkak të një takimi tjetër më duhet ta lëshoj mbledhjen, ndërsa për kryesimin e mbledhjes autorizoj z.Faik Muçiqi.

z.Qefser Behrami, theksoi, sa i përket sigurisë në shkollë po i referohem raportit të Komandantit të Stacionit të Policisë me ç'rast jam shumë i kënaqur me angazhimet e tij dhe zyrtarëve policorë. Në fillim të procesit mësimor na është shfaqur problem me prindërit e nxënësve të cilët nuk respektonin masat anti Covid-19, me intervenimin njoftuar Komandantin e Policisë dhe është zgjidhur problemi. Shqetësim tjetër është siguria në rrugën magjistrale Podujevë-Mitrovicë ku ka qarkullueshmeri të madhe dhe vozitës të pa ndërgjegjshëm andaj ne kërkojmë vendosjen e një pengese në këtë rrugë. Gjithashtu si shqetësim kemi zhurmën e tre motoçiklistëve të cilët sillen rreth shkollës të cilët po pengojnë mbarëvajtjen e mësimit. Çështje tjetër kemi objektin e shkollës së vjetër të fshatit, i cili është objekt i vjetër dhe historik dhe që i plotëson të gjitha kushtet për renovim sepse kostoja është më e ulët që të rinovohet se sa të rrënohet. Në shkollën e fshatit Pakashticë kompania KEDS ka dëmtuar trotuarin dhe nuk e ka bërë rregullimin e tij, dëmtimi paraqet rrezikshmëri për sigurinë e nxënësve. Procesi mësimor në shkollën e fshatit Kërpimëh është duke u zhvilluar në kushte shumë të mira, hapësira është shumë e madhe në mes nxënësve, probleme nuk ka. Sa i përket trotuareve, në fshatin Metehi është duke u ndërtuar trotuari nga rruga që të shpie deri te shkollë e fshatit Metehi. Para ca dite ka ndodhur një aksident në trafik ku një makinë është rrokullisur në rrugën Podujevë-Kërpimëh, si pasojë e shpejtësisë së madhe dhe ndërtimit jo të duhur të trotuarit.

z. Faik Muçiqi theksoi, duke iu drejtuar parafolesit theksoi, çështjet e ngritura lidhur me procesin mësimor t'i adresoj në Drejtorinë e Arsimit, e kuptoj shqetësimin dhe kërkesën e banorëve për vendosjen e një pengese në rrugën magjistrale Podujevë-Mitrovicë, mirëpo sa i përket çështjes së trotuarit në rrugën Podujevë –Kërpimëh ndërtimi i tyre me kriteret infrastrukturore dmth është 18 cm deri 25 cm mbi asfalt, mirëpo rastet kur vozitësit janë të pa kujdesshëm dhe hyjnë në trotuar, kjo bëhet si rezultat i pakujdesisë së tyre. Çështjet që i ka në kompetencë Këshilli duhet adresuar në këshill ndërsa për ato çështje që i ka në kompetencë Drejtoria është mirë që të zgjidhen nga ana e saj. Lidhur me problemet me KEDS-in me këtë duhet të merret edhe Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim. Për çdo problematikë që ka të bëjë me çështjet mësimore duhet të drejtoheni në Drejtorinë e Arsimit.

z. Agim Blakçori, theksoi, me temat që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Arsimit, në nivel të shkollave, mos ta ngarkojmë Këshillin. Në bazë të detyrave dhe përgjegjësiave ne si DKA veprojmë në shkolla.

z. Qefser Behrami theksoi, nuk jam duke folur në cilësinë e drejtorit të shkollës por si përfaqësues i asaj pjese të lokaliteteve, çështjet që i ceka kanë të bëjnë me sigurinë në shkolla, ndërsa çështjet e shkollës i diskutoj në nivel shkolle.

z. Faik Muçiqi theksoi, dua të jap një sqarim, çështjet që kanë të bëjnë me raportet e drejtorëve të shkollave janë çështje të DKA-së, ndërsa çështjet që kanë të bëjnë me qytetarët ju drejtohen drejtorisë kompetente me shkrim, kështu që mos t'i ngatërrojmë kompetencat Këshill-Drejtori. Çështja e ish objektit të vjetër të shkollës së fshatit Kërpimëh është çështje që përsëritet disa herë, ku kompetentë për këtë janë Drejtori i Drejtorisë përkatëse dhe Kryetari i Komunës, ku vendoset se a do të rrënohet apo rinovohet ai objekt, sepse për këtë objekt nuk vendos këshilli. Planin e KKSB-së për këtë vit jemi duke e përmbyllur, kemi edhe mbledhjen e fundit që kemi temat sipas planit pavarësisht pengesave që kemi pas në fillim të vitit. Nëse dikush nga ju nuk ka ndonjë pyetje faleminderit për pjesëmarrje, shihemi në mbledhjen e fundit për këtë vit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/04-0057344/20
Podujevë, 23 tetor 2020**

**Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari**